

Përmbledhje e shkurtër si një ekstrakt nga kumti
për 112 vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe Alfabetit të shqipes

DRITËHIJE DHE PERSONALITETI I ALFABETIT TË SHQIPES

Nga Xhevair Lleshi

Edhe në muzg pale në agim të jetës së një njeriu e të një kombi rrugët na çojnë tek arsyet që kërkon shkrimi i një gjuhe, të cilat natyrshëm janë të ndryshme, por «shtysat më vepruese vijnë nga kërkesat e ekonomisë, të tregtisë, të shtetit dhe të fesë.»¹⁾ (Xh. Lloshi...«Rreth Alfabetit të Shqipes, 2008) Si një plak që hulumtonte ende shkronja të reja, mua do t' më pëlqente gjithnjë ai përfytyrim. Ndërkaq, kërkesat pas hulumtimit bëheshin edhe më tepër të nevojshme që të gjenin mbështetjen e duhur, që e sjell padyshim përpunimi i shkrimit konkret të gjuhës. Dhe Plaku i përfytyruar i shkronjave shqip qëmtonte në heshtje. Gjuha shqipe gjithashtu do të shkruhej tanimë kurse shkrimi shqip do t' u shërbente të gjithëve, ekonomisë, tregtisë, shtetit dhe fesë po ashtu, krejt shqiptarëve, domethënë do të bëhej shpejt gjuhë e shkruar sunduese që të arrinte ta mbante e ta mbulonte plotësisht komunikimin e shkruar me shqiptarët.

Po edhe gjatë këtij sundimi Plaku mbeti mes nesh. A e dini ç'bënte? Nxirrte cipën e sipërme të sundimit të huaj nga gjuha e vjetër, ngushtuar nën shkronjat e reja, dhe u kthehej gjërave të reja me bollëk dhe frymëzim të rrallë. Popullsia e donte këtë «magji» dhe e përpinte pastaj me librat dhe përgatitej me dinjitet për shtetin e ri që po lindte, ashtu si dhe alfabetin i ri. Ai kish humbur për një kohë të gjatë, kurse Plaku e shihte tërë dinjitet të porsalindurin, se shpejt do të bëheshin të dy vocërrakët (shteti dhe alfabeti) që do të donin kohë të mëkëmbeshin. Fytyra e shekullit të ri (shek.XX) ishte e ftohtë, dhe kjo dukej qartë, ashtu si fytyra e Plakut.

Qe mbrujtur vetëdija kombëtare e shqiptarëve, tashmë ishin në përdorim disa alfabete, ardhur deri aty sa u pranua me një zë alfabeti i ri me fytyrën e lashtësisë së pamohueshme. Plaku do t' i jepte personalitet. Komunikim në shkallë kombëtare, me zërin e magjishëm të Rilindjes Kombëtare, duke e ngulitur fort si një alfabeti të vetëm. Plaku, megjithatë, e quajti të domosdoshme të vinte në dukje, se bashkë me gjërat madhore të jetës, u ndërthurën edhe ato më të ngushta kulturore e drejtpërdrejt gjuhësore, që «e përshpejtuan vendosjen e një alfabeti të vetëm»²⁾ (Xh. Lloshi...«Rreth Alfabetit të Shqipes, 2008)

*Plaku është simbol i trashëgimisë së lashtë të gjuhës shqipe